



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. 3522 prot.

Tiranë, më 30/07/2026

Lënda: Depozitim projektligji.

Drejtuar: Z. Niko PELESHI
KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

I nderuar z. Kryetar,

Bazuar në nenin 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 68, të Rregullores së Kuvendit, Ju paraqes për shqyrtim dhe miratim **projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”**.

Ju faleminderit.

DEPUTETËT PROPOZUES

1. *Fatoua Zylykbashi (Fatoua)*
2. *Admir Kadeli*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____ / ____ 2026

**“PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 96/2016 “PËR STATUSIN E
GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve, 78, 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim deputetësh,
KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 12 të ligjit nr. 96/2016, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 4 ndryshohet si vijon:

“4. Për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, shtesa për vjetërsi llogaritet në masën 2 përqind të pagës referuese bazë për çdo vit të përvojës profesionale juridike të njohur si kusht për emërimin në këtë detyrë, por jo më shumë se 25 vjet”.

2. Në pikën 5, shkronja “a”, fjalia e parë ndryshon si më poshtë:

“a) paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë, e cila është e njëjtë me shumëzimin e koeficientit 0.38 me pagën e Presidentit të Republikës. Paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë indeksohet me vendim të Këshillit të Ministrave jo më vonë se dy vjet nga indeksimi i fundit. Niveli i indeksimit në çdo rast nuk kalon një pikë përqindjeje mbi nivelin e targetuar të inflacionit nga Banka e Shqipërisë.”.

3. Në pikën 5, shkronja “d”, ndryshon si më poshtë:

“d) shtesë për vështirësi pune, në masën 80 përqind të pagës bruto fillestare, për magistratët që ushtrojnë funksionin pranë Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Gjykatës së Shkallës së parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, për Prokurorin e Përgjithshëm, si dhe për gjyqtarët që ushtrojnë funksionin në Gjykatën e Lartë”.

4. Në pikën 5, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “dh” me përmbajtjen si më poshtë:

“dh. shtesë për funksionin në masën 5 përqind të pagës bruto fillestare, për Prokurorin e Përgjithshëm, si dhe për gjyqtarët që ushtrojnë funksionin në Gjykatën e Lartë”.

5. Pas pikës 5 shtohet pika 6 me përmbajtjen si më poshtë:

“6. Shtesat e parashikuara në shkronjat “d” dhe “dh” të pikës 5, të këtij neni, përtej gjyqtarëve që ushtrojnë funksionin përkatës, sjellin efekte vetëm për pagën e anëtarëve dhe kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, sipas referencës në nenin 17 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” i ndryshuar. Këto shtesa nuk gjejnë zbatim për funksionarët e tjerë publikë, kur pagat e tyre referojnë te paga e gjyqtarit ose kryetarit të Gjykatës së Lartë, apo e Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare dhe pika 2 e nenit 1 të tij i shtrin efektet financiare prej datës 01.04.2023.

K R Y E T A R I

NIKO PELESHI

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 96/2016 “PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji synon miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” duke përmbushur detyrimin kushtetues të vendosur nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 15, datë 17.02.2026 (V-15/26), i cili, në pikën 2 të dispozitivit, ka vendosur shfuqizimin e fjalisë së parë të shkronjës “a” të nenit 1, si dhe të pikës 2 të nenit 2 të ligjit nr. 33/2023, datë 25.05.2023 “Për një ndryshim në ligjin 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Me miratimin e këtij projektligji, Kuvendi zbaton një nga detyrimet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për të plotësuar ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me norma të cilat garantojnë përllogaritjen e pagës së magjistratëve (gjyqtarë dhe prokurorë), në përputhje me vendimin e Gjykatës.

Me këtë vendim, Gjykata ka detyruar shprehimisht Kuvendin të miratojë ndryshimet ligjore të nevojshme, sipas arsyetimit të këtij vendimi, brenda datës 31.07.2026. Për rrjedhojë, ky projektligj është përgjigjja ligjvënëse ndaj këtij detyrimi kushtetues, brenda afatit të përcaktuar.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk propozohet në zbatim të programit politik të Këshillit të Ministrave pasi është iniciativë ligjore deputetësh, në kuadër të procesit të ndjekur nga Kuvendi i Shqipërisë për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Konteksti i mosmarrëveshjes kushtetuese

Gjykata Kushtetuese, në shqyrtimin e kërkesës së Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë, arriti në përfundimin se formula e miratuar me ligjin nr. 33/2023 përbënte shkelje të nenit 138 të Kushtetutës. Sipas Gjykatës, ndryshimi ligjor i fundit, objekt i këtij gjykimi kushtetues, ka lëvizur referencën në formulën e përlllogaritjes së pagës së magjistratëve dhe ka shkaktuar de facto ngrirjen e shënjestruar të pagës, pavarësisht se të dyja pagat referenciale, e mëparshmja dhe aktualja, janë rritur në mënyrë domethënëse.

Të dhënat ekonomike që mbështesin ndryshimin

Vendimi dokumenton se, ndërkohë që paga e magjistratëve mbeti e ngrirë, në periudhën nga fillimi i zbatimit të ligjit (viti 2019) dhe deri në vitin 2023, kur u miratuan ndryshimet ligjore të kundërshtuara, paga e nëpunësit civil të referencës] është rritur me afërsisht 44%. Për sa i përket pagës së Presidentit, që për një periudhë të gjatë kohore kishte ndryshuar me vlera të vogla, ajo është rritur me afërsisht 65%.

Mekanizmi i indeksimit si garanci kundër inflacionit

Projektligji ruan mekanizmin e indeksimit të pagës referuese bazë, në përputhje me kërkesën e Gjykatës që formula të mos e lërë pagën të ngrirë ndaj inflacionit. Sipas Gjykatës, inflacioni i qëndrueshëm/i vazhdueshëm, nëse nuk kompensohet nga rritja e pagave, funksionon si një ulje de facto e tyre, gjë që mund të minojë pavarësinë e gjyqtarëve. Për këtë qëllim, Gjykata ka theksuar nevojën për miratimin e mekanizmave ligjorë të indeksimit ose rishikimit periodik, që të ofrojnë mbrojtjen kundër uljes së vlerës reale të pagës për shkak të kostos së jetesës (inflacionit).

Zgjidhja e ofruar nga Gjykata

Projektligji zbaton drejtpërdrejt orientimin e Gjykatës në pikën 109 të vendimit, sipas së cilës Kuvendi mund të zgjedhë të përshtasë formulën e re në mënyrë që të riparojë uljen e fshehtë ose duke iu referuar ndryshimit që pësoi kategoria e nëpunësve civilë në të cilët referonte formula e vjetër ose ndryshimit që pësoi paga e Presidentit, ose çdo zgjidhjeje tjetër të krahasueshme me ndryshimet e kategoritë e mësipërme dhe brenda limiteve të tyre, gjithnjë në respektim të garancive të nenit 138 të Kushtetutës.

Përshtatja e trajtimit brenda hierarkisë gjyqësore

Shtesat e reja të parashikuara në projektligj për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë i përgjigjen edhe një gjetjeje konkrete të KLSH-së, të evidentuar nga vetë Gjykata: në raportin e vitit 2023 të auditimit financiar dhe të përputhshmërisë për veprimtarinë e Gjykatës së Lartë, KLSH-ja ka gjetur se pagat e gjyqtarëve të asaj gjykate, ndonëse i përkasin gjyqtarëve që ushtrojnë detyrën në të njëjtën gjykatë, janë të ndryshme dhe konstatohen tre nivele, duke rekomanduar marrjen e masave për hartimin e ndryshimeve ligjore për trajtimin e tyre financiar sa më drejt dhe në masë sa më të përafërt.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është tërësisht në përputhje me nenin 78, 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, si dhe garanton respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit.

Projektligji miratohet bazuar në mbështetje të neneve 78, 81, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin deputetësh por në kuadër të iniciativës së Kuvendit për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE-SË (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVË)

Projektligji nuk përfron akte të legjislacionit të Bashkimit Europian.

Projektligji synohet të miratohet në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar me 2 nene, me përmbajtje si më poshtë:

Neni 1 parashikon shtesat dhe ndryshimet në nenin 12 të ligjit nr. 96/2016, si vijon:

Në nenin 12 të ligjit nr. 96/2016, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 4 ndryshohet si vijon:

“4. Për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, shtesa për vjetërsi llogaritet në masën 2 përqind të pagës referuese bazë për çdo vit të përvojës profesionale juridike të njohur si kusht për emërimin në këtë detyrë, por jo më shumë se 25 vjet”.

2. Në pikën 5, shkronja “a”, fjalja e parë ndryshon si më poshtë:

“a) paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë, e cila është e njëjtë me shumëzimin e koeficientit 0.38 me pagën e Presidentit të Republikës. Paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë indeksohet me vendim të Këshillit të Ministrave jo më vonë se dy vjet nga indeksimi i fundit. Niveli i indeksimit në çdo rast nuk kalon një pikë përqindjeje mbi nivelin e targetuar të inflacionit nga Banka e Shqipërisë.”.

Lidhur me koeficientin 0.38 është përcaktuar si rezultat i një vlerësimi të balancuar ndërmjet nevojës për forcimin e garancive materiale të pavarësisë së magjistratëve dhe detyrimit për të respektuar parimet e proporcionalitetit, qëndrueshmërisë dhe koherencës së sistemit të pagave në sektorin publik pasi magjistrati me i thjeshtë, në gjykatat e rrethit barazohet në page me kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin, ose në koeficient në masën 0.91 të pages së Presidentit. Ky nivel konsiderohet i mjaftueshëm për të përmbushur objektivin e projektligjit, pa krijuar pabarazi të pajustificuara ose pasoja joproporcionale për financat publike.

3. Në pikën 5, shkronja “d”, ndryshon si më poshtë:

“d) shtesë për vështirësi pune, në masën 80 përqind të pagës bruto fillestare, për magjistratët që ushtrojnë funksionin pranë Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Gjykatës së Shkallës së parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, për Prokurorin e Përgjithshëm, si dhe për gjyqtarët që ushtrojnë funksionin në Gjykatën e Lartë”.

4. Në pikën 5, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “dh” me përmbajtjen si më poshtë:

“dh. shtesë për funksionin në masën 5 përqind të pagës bruto fillestare, për Prokurorin e Përgjithshëm, si dhe për gjyqtarët që ushtrojnë funksionin në Gjykatën e Lartë”.

5. Pas pikës 5 shtohet pika 6 me përmbajtjen si më poshtë:

“6. Shtesat e parashikuara në shkronjat “d” dhe “dh” të pikës 5, të këtij neni, përtej gjyqtarëve që ushtrojnë funksionin përkatës, sjellin efekte vetëm për pagën e anëtarëve dhe kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, sipas referencës në nenin 17 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” i ndryshuar. Këto shtesa nuk gjejnë zbatim për funksionarët e tjerë publikë, kur pagat e tyre referojnë te paga e gjyqtarit ose kryetarit të Gjykatës së Lartë, apo e Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 2 parashikon se ligji hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare, ndërsa pika 2 e nenit 1 i shtrin efektet financiare prej datës 01.04.2023. Ky parashikim i efekteve financiare prapavepruese zbaton drejtpërdrejt orientimin e Gjykatës Kushtetuese, e cila ka përcaktuar se efektet financiare të ligjit të ri duhet të llogariten po nga data 01.04.2023, duke përcaktuar një skemë të arsyeshme përshtatjeje për pagesat e prapambetura për periudhën nga data 01.04.2023 deri në hyrjen në fuqi të ligjit të ri.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucioni i ngarkuar për zbatimin e këtij projektligji është Ministria e Financave, lidhur me efektet financiare që do të rrjedhin nga zbatimi i ligjit, përfshirë llogaritjen e pagesave të prapambetura nga data 01.04.2023.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji u hartua nga deputetët propozues me asistencën e shërbimeve juridike të Kuvendit të Shqipërisë. Gjatë vlerësimit në Kuvend të vendimit të Gjykatës Kushtetuese u dërgua shkresë drejtuar Ministrisë së Financave lidhur me efektet financiare që duhen përllogaritur nga zbatimi i vendimit të GjK.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Relacion për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime dhe ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, te ndryshuar”.

Projektligji sjell efekte financiare shitesë në buxhetin e shtetit, pasi parashikon rritje pagash për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, anëtarët dhe kryetarin e Gjykatës Kushtetuese dhe Prokurorin e Përgjithshëm. Po ashtu, nga mënyra e përlllogaritjes së pagave do të ketë rritje edhe për të gjithë magjistratët e sistemit të drejtësisë (gjyqtarë dhe prokurorë të të gjitha niveleve).

Efekti financiar përfshin edhe pagesat e prapambetura, të cilat, sipas nenit 2 të projektligjit, llogariten prej datës 01.04.2023. Efekti financiar do të përballohet nga buxheti i shtetit dhe do të përlllogaritet në vlera konkrete pas miratimit të projektligjit. Pagesat e prapambetur prej datës 01.04.2023, do të paguhet e ndarë në disa vite buxhetore.